



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 12/12/2016

RAPORT I MBAJTUR NË TAKIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE ME BANORËT
NJËSISË ADMINISTRATIVE DRENOVË

Morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë, banorë të njësisë administrative Drenovë dhe organizata të tjera .

Në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2017 takuam banorët e Njësisë Administrative Drenovë në datë 12/12/2016 për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë. Një diskutim i cili u mbështet tek punët dhe investimet e kryera gjatë kësaj kohe si dhe kërkesat e nevojat e tyre prioritare në lidhje me përmirësimin e ndriçimit publik e furnizimit me ujë të pijshëm, vazhdimësinë e punës për pastrimin dhe sistemimin e kanaleve ujitës dhe kullues në parcelat bujqësore dhe sistemimi i rrugëve hyrëse në fshatra.











